



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*

*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,  
Entrepreneurship and Trade*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

**Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin  
"Hannover Messe 2025" në Gjermani**

Data e organizimit:  
31 mars - 04 prill 2025  
Adresa: Messengelände  
30521 Hannover

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të sektorit të Teknologjisë Informative (TIK) dhe sektorit të Përpunimit të Metalit, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e standës, regjistrimin e 10 subjekteve pjesëmarrëse (5 prej tyre nga sektori i TIK-ut; dhe 5 prej sektorit të përpunimit të metalit), shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 19.02.2025. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;

7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kritereve në vijim dhe vlerësimin të pikëve do të përzgjidhen 10 subjekte:

- 5 nga sektori i TIK-ut; dhe
- 5 nga sektori i përpunimit të metalit

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
  - 1 pikë për 1 produkt
  - 3 pikë për 2 produkte
  - 5 pikë për 3 produkte
  - 7 pikë për 4 produkte dhe
  - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 5 pikë
  - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë angleze 4 pikë
  - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet/shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2024, maksimum 10 pikë:
  - Shtetet e BE-së 5 pikë
  - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
  - Shtetet tjera 2 pikë.

- Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:
  - ISO 27001 3 pikë dhe
  - Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panair apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
  - 1 deri në 3 panair 3 pikë
  - 3 deri në 6 panair 5 pikë.

Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2024, maksimumi 10 pikë:

- 0 - 500.000 euro 4 pikë
  - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
  - > 1,000.000 euro 10 pikë.
- Për kompanitë Start-up, qarkullimi i subjektit aplikues në vitin 2024, maksimumi 10 pikë:
    - 0 - 50.00 euro 4 pikë
    - 50.01 – 5,000 euro 8 pikë dhe
    - > 5,000 euro 10 pikë;

Më 13.02.2025, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 19.02.2025 në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit: [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe [kiesa.rks-gov.net](http://kiesa.rks-gov.net) apo në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)